



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Laboratori Eksperimental në ish- Kombinatin Metalurgjik, i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në kuadër të përmbushjes së detyrimit të realizimit të vlerësimit të sistemit të brendshëm, kërkon një ekspert “Specialist i Auditimit të Brendshëm”, i licencuar sipas standartit EN ISO 17025:2017”, me kohë pune të reduktuar vetëm për 1(një) muaj.

Prania e audituesit është e domosdoshme për shkak të realizimit të detyrimit të vlerësimit të sistemit të brendshëm një herë në vit, brenda 6-muajve pas vizitës vlerësuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në përmbushje të standartit EN ISO 17025:2017. Audituesi do të auditojë: dokumentacionin e menaxhimit të laboratorit; mirëadministrimin e dosjeve që laboratori ka në përdorim; regjistrat e rishikimit të menaxhimit dhe kërkesave të klientëve; raportet e provave dhe përpunimit të të dhënave të marra nga testimet; dosjet e personelit dhe realizimin e planit të trajnimit të tyre; certifikatat e kalibrimit të pajisjeve testuese; zbatimin e procedurave teknike në provat fiziko mekanike dhe kimike.

Audituesi duhet: të jetë i pavarur nga organizimi i Vlerësimit të Konformitetit (Laboratori i akredituar); të jetë i licencuar për këto auditime, të ketë certifikatë trajnimit sipas standartit EN ISO 17025:2017; të njohë natyrën e testimeve në laborator.

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të ndryshuar si dhe nisur nga objekti i punës që do të kryejë, audituesi duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret si më poshtë:

1. Të jetë i certifikuar për njohjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas sipas standartit EN ISO 17025:2017 dhe të ketë certifikatë të lëshuar nga DA.
2. Të ketë kualifikim dhe certifikim si Auditues i SMC sipas standartit ISO 19011 nga Organizata Europiane e Cilësisë
3. Të ketë eksperiencë pune si auditues dhe të ketë aftësi komunikimi me nënpunësit e strukturave që auditon.
4. Të ketë mbaruar studimet në Inxhinieri, preferohet dega inxhinieri mekanike.
5. Të ketë aftësi për vlerësim të pavarur dhe me objektivitet.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve **(08.09.2025 – 17.09.2025)** dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

1. Jetëshkrimin e tij/saj;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

2. Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
3. Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
4. Vërtetim nga punëdhënësi dhe leje nga punëdhënësi;
5. Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të kërkuara;
6. Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
8. Fotokopje e letërnjoftimit.

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist auditimi*.
Elbasan**